

## Njoftim

Sot, më datë **06.06.2023**, ora **09:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Manjola Xhaxho (Relatore);**
- 2. Blerona Hasa (Anëtare);**
- 3. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, mori në shqyrtim çështjen Nr.26 Regj.Themeltar, Datë 02.06.2023 Regjistrimi, me:

**Paditës:** Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Kuçovë, përfaqësuar nga Avokatët Arben Llangozi dhe Orgesa Serani.

**Të paditur:** Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.  
Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror.

**Objekti:** Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

**Baza ligjore:** Neni 124 e vijues i Kodit Zgjedhor, neni 4, 13, 14, 23, 24, 90, 109, 116 i Kodit të Procedurave Administrative.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me vendim të ndërmjetëm, vendosi **bashkimin e kësaj çështje me çështjen nr.28 Regj. Themeltar, Datë 05.06.2023 Regjistrimi**, me:

**Paditës:** Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Altin Kaziaj.

**Të paditur:** Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror.

**Objekti:** Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

Për një proces të rregullt ligjor, seanca gjyqësore për shqyrtimin e këtyre dy çështjeve u planifikua më datë **07.06.2023**, ora **08:45** në: **ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë.**

**Tiranë, më 06.06.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**